

Forumi i Politikave të Integritimit monitoron nga afër procesin e integritimit në Bashkimin Evropian dhe institucionet e përfshira në të, duke u përqendruar kryesisht në koordinimin ndërinstytucional ndërmjet njërive dhe dokumenteve dhe raporteve të tyre ligjore. Treguesit e monitorimit dhe rregullat metodologjike përfshijnë aktet normative dhe/ose legjislativë të miratuara; aktivitetet e kryera (numri i takimeve, plan-veprimeve, raportet, strategjitë për të adresuar mangësitë e identifikuar nga raporti i KE, etj.); fazën e zhvillimit paraprakisht të instrumenteve; si dhe shqyrtimin institucional dhe publik të rezultateve të arritura.

THEMELIMI I KËSHILLIT KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE: SFIDË APO ARRITJE?

Gentiola Madhi
EU Policy Hub

PANORAMA E PËRGJITHSHME

Organizatave të shoqërisë civile (OSHC)¹ luajnë një rol të rëndësishëm në forcimin e proceseve demokratike dhe konsolidimin e qeverisjes së mirë dhe transparencës, ndaj kontributi i tyre duhet kanalizuar nëpërmjet ngritjes së mekanizmave institucionale të bashkëpunimit me institucionet publike. Në Shqipëri, përgjatë 20 viteve të fundit, OSHC-të kanë pësuar një transformim të konsiderueshëm, ndonëse [procesi i maturimit të tyre nuk ka përfunduar ende](#). Gjithsesi, përtej sfidave të hasura deri më tani, [këta aktorë duhet të shihen si një komponent thelbësor për demokratizimin e vendit dhe të trajtohen si të tillë nga institucionet e administratës publike](#). Me kalimin e kohës është treguar gjithmonë e më shumë interes nga qeveritë për përfshirjen e OSHC-ve në proceset politikëbërëse dhe në këtë kuadër është investuar për ngritjen e mekanizmave institucionale të bashkëpunimit.

Në vitin 2015 Parlamenti shqiptar miratoi [ligjin nr. 119 për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile \(KKSHC\)](#), me qëllim mundësimin e një

mekanizmi dialogu në nivel ndërsektorial midis qeverisë dhe OSHC-ve. Gjeneza e hartimit të këtij ligji dhe konkretizimit të bashkëpunimit midis palëve në një strukturë këshillimore dhe autonome daton që me miratimin e [Udhërrëfyesit të politikës së qeverisë për të krijuar një mjedis mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile, 2013-2017](#). Mandej, qeveria shqiptare u zotua zyrtarisht përpara Bashkimit Evropian për ngritjen e këtij mekanizmi konsultiv gjatë [takimit të parë të Dialogut të Nivelit të Lartë](#), konkluzionet e përbashkëta të së cilit deklarorin se ky këshill do të mundësonte përfshirjen e shoqërisë civile në proceset reformuese, si dhe do të krijonte një kuadër për kanalizimin e ekspertizës së këtij sektori në proceset politikëbërëse.

[Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile](#) përbëhet nga 27 anëtarë, prej të cilëve 13 janë përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, të zgjedhur nëpërmjet një procesi online, i cili është menaxhuar nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC). Synimi madhor i këshillit është ndërtimi i një dialogu të vazhdueshëm për krijimin e një kuadri mundësues për sektorin e shoqërisë civile dhe pjesëmarrjen e tyre në proceset politikëbërëse, bazuar në tre parime, përkatësisht këshillimi, transparenca dhe konsultimi me grupet e interesit. Procesi

¹ Në këtë punim përdoret përkufizimi i ligjit 119/2015 për termin OSHC: "organizata të shoqërisë civile, të cilat mund të jenë organizata jofitimprurëse ose entitete të tjera të shoqërisë civile, që nuk janë regjistruar si OJF, por që ushtrojnë veprimtari në të mirë dhe interes publik".

i përzgjedhjes së anëtarëve nga shoqëria civile zgjati gjithsej 6 muaj (dhjetor 2015 - qershor 2016), ndërsa konstituimi efektiv i KKSHC-së u bë në dhjetor 2017. Procesi i themelimit të këshillit ka shkaktuar debate midis OSHC (joanëtare) mbi mangësi në respektimin e parimeve të transparencës dhe gjithëpërfshirjes në ngritjen e këtij mekanizmi.

Ky punim synon të kontribuojë në dokumentimin e procesit të themelimit të KKSHC-së, në mënyrë që të mundësojë një advokim më të madh mbi përfshirjen konstruktive të shoqërisë civile në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse. Punimi synon të rrisë transparencën mbi punën e bërë nga këshilli deri në muajin qershor 2018. Ai fokusohet tek sfidat e hasura gjatë procesit të themelimit – si në perspektivën e kuadrit ligjor në fuqi, ashtu edhe në perspektivën e kapaciteteve të nevojshme për mirëfunksionimin e këtij mekanizmi ndërsektorial. Pas ofrimit të një panoramë të shkurtër të eksperiencave të ngjashme në Kroaci dhe Mal të Zi, analiza do të mbyllet me disa rekomandimesh specifike me qëllim forcimin e rolit dhe kontributit të KKSHC-së.

Përsa i përket aspektit metodologjik, punimi ka natyrë cilësore. Burimet parësore konsistojnë në analizimin e përmbajtjes së procesverbaleve të mbledhjeve të organizuara (p.sh mbledhjet e këshillit dhe takimet e organizuara me anëtarët përfaqësues të OSHC-ve), intervista me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile - anëtare dhe joanëtarë të KKSHC-së, - si dhe me përfaqësues nga sekretariati teknik i këshillit. Ndërsa burimet dytësore të përdorura i referohen raporteve të publikuara nga institucione ndërkombëtare (Komisioni Evropian dhe Freedom House), publikimet e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (18 artikujt e publikuar në ditarin periodik të përtremuajshëm), si dhe mbulimi nga media online. Janë konsultuar gjithashtu postimet e bëra në llogarinë në median sociale të AMSHC-së (gjithsej 41

postime dhe 2 evente të krijuara në facebook), të konsideruar si burim i vlefshëm në formë ditari elektronik për hapat e ndërmarrë në harkun kohor 2015-2018 për themelimin dhe funksionimin e KKSHC-së.

MANGËSITË E KUADRIT LIGJOR

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile është organ kolegjal këshillimor dhe autonom, i ngritur pranë Këshillit të Ministrave. Ai synon të forcojë bashkëpunimin sistematik ndërsektorial midis organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve publike, si pjesë e një dialogu politikash kombëtar gjithëpërfshirës, si dhe në kuadër të proceseve demokratizuese të vendit.

Bazuar në nenin 8 të ligjit 119/2015, KKSHC ka tre objektiva madhorë, përkatësisht: (i) këshillon dhe i jep rekomandime qeverisë për politikat publike që ndikojnë në zhvillimin e shoqërisë civile dhe përfshirjen e saj në bashkëpunimin ndërsektorial; (ii) këshillon qeverinë për përmirësimet legjislative që nxisin zhvillimin e shoqërisë civile dhe përfshirjen e saj në proceset vendimmarrëse; dhe, (iii) i jep mendime qeverisë dhe AMSHC-së për planifikimin e prioriteteve lidhur me shpërndarjen e fondeve publike, fondeve të BE-së dhe donatorëve të tjerë ndërkombëtarë, që në fokus kanë zhvillimin e shoqërisë civile.

Këshilli përbëhet nga 27 anëtarë, prej të cilëve 13 janë përfaqësues të institucioneve publike, 13 janë përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe 1 përfaqëson komunitetin e biznesit, përkatësisht nga Këshilli Ekonomik Kombëtar. Ligji përcakton që kryetari i KKSHC-së është Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ndërkohë me ndryshimet e strukturës së Këshillit të Ministrave në shtator 2017, ky pozicion mbulohet aktualisht nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Zëvendëskryetari zgjidhet nga radhët e

përfaqësuesve të OSHC-ve anëtare në këshill.

AMSHC shërben si sekretariat teknik i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile, duke mundësuar kështu ushtrimin e funksioneve ndihmëse dhe administrative. Kjo agjenci publike mbulon nga buxheti i saj shpenzimet e kryera në kuadër të aktiviteteve të ndërmarra për përmbushjen e funksioneve të këshillit; ndërsa kontributi i anëtarëve të KKSHC-së është në bazë vullnetare.

Ligji përcakton që këshilli të mblidhet të paktën tre herë në vit, si dhe atëherë kur kërkohet mbledhja e tij nga të paktën 9 anëtarë. Mbledhjet organizohen pranë mjediseve të Kryeministrit dhe janë të vlefshme kur marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve. KKSHC raporton pranë Këshillit të Ministrave për veprimtarinë vjetore dhe ky raport publikohet në faqen e saj të internetit për konsultim publik. Ai funksionon sipas [rregullores së brendshme](#), e cila u miratua në [takimin e datës 26/12/2017](#). Kjo rregullore sanksionon organizimin e procesit të këshillimit, konsultimit dhe transparencës, zhvillimin e mbledhjeve, si dhe hartimin e raportit vjetor.

Përsa i përket zbatueshmërisë së ligjit për themelimin dhe funksionimin e KKSHC-së, versioni aktual ka disa mangësi apo pasaktësi, të cilat nevojitet që të rishikohen në një kohë sa më të afërt nga aktorët përkatës. Problematika e parë lidhet me **kohëzgjatjen e mandatit të anëtarëve** të KKSHC-së, e cila varion në bazë të pozicionit që ata ushtrojnë, përkatësisht:

(i) mandati i **anëtarëve përfaqësues të institucioneve publike** përkon me ushtrimin e detyrës në institucionin që ata përfaqësojnë (neni 6 i ligjit). Ligji përcakton qartë se cilat janë ministritë pjesë e këtij këshilli dhe niveli i pjesëmarrjes duhet të jetë në rang

zëvendësministrash ose nivele të tjera të larta drejtuese;

(ii) **anëtarët përfaqësues të OSHC-ve** kanë një mandat tre vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje një herë (përjashtim bëjnë anëtarët e parë që do kenë mandate një, dy dhe tre vjeçar sipas shortit që organizon AMSHC në respekt të dispozitave kalimtare) (neni 9 dhe 16 i ligjit);

(iii) ndërsa **anëtari nga Këshilli Ekonomik Kombëtar** ka një mandat të paqartë. Ndërsa neni 6/2 i ligjit specifikon se "*[m]andati i [...] përfaqësuesit të Këshillit Ekonomik Kombëtar në KKSHC është i lidhur me afatin, gjatë të cilit [ai] ushtro[n] detyrën përkatëse publike, për shkak të së cilës caktohe[t] dhe anëtar [i] KKSHC-së*", neni 9/1 shprehet që "*[k]ohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të KKSHC-së, përfaqësues të OJF-ve, [...] është tre vjet, me të drejtë rizgjedhjeje një herë, përfshirë edhe përfaqësuesin e Këshillit Ekonomik Kombëtar*". Në këtë pikë lind natyrshëm pyetja nëse gëzon përfaqësuesi i komunitetit të biznesit një mandat të lidhur me detyrën që ai ushtron në Këshillin Ekonomik Kombëtar apo është i detyruar të respektojë klauzolën e mandatit tre vjeçar, të rinovueshëm një herë (pra 3 vjet plus 3 vjet)?

Së dyti, ekziston një **mospërputhje mbi numrin e saktë të anëtarëve** të OSHC-ve. Në nenin 6/6 të ligjit 119/2015 specifikohet që: "*OJF-të zgjedhin si anëtarë të tyre në KKSHC katër përfaqësues të shoqërisë civile për secilin nga sektorët e mëposhtëm: a) demokratizimi, shteti i së drejtës, të drejtat e njeriut dhe integrimi në BE; b) zhvillimi ekonomik, territorial dhe mjedisor; c) mirëqenia, shërbimet sociale, mbrojtja e shëndetit dhe përmirësimi i cilësisë së jetës*". **'Formula 4-4-4'** e sanksionuar në ligj është e pasaktë sepse numri total i anëtarëve të OSHC-ve është

13. Kjo mospërputhje rezulton prezente edhe në nenin 5 të rregullores së KKSHC-së. Së treti, ligji ndjek një qasje të detajuar përsa i përket identifikimit dhe pjesëmarrjes së përfaqësuesve të ministrive anëtare në këshill. Ky rregullim strikt çon në një influencim të drejtpërdrejt të punës së KKSHC-së sa herë që ndryshon struktura e qeverisë. Në këtë linjë, ndryshimet e qeverisë së formuar në shtator 2017 krijuan boshllëqe në përfaqësim, çka detyroi KKSHC-në të vendoste me unanimitet në mbledhjen e datës 26.12.2017 se cilat ministri do të zëvendësonin ministrinë që nuk ekzistonin më (si p.sh. Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, etj.). Ndaj, ndonëse kërkon kohë materiale, rishikimi i ligjit është i domosdoshëm për të evituar *qasjet ad hoc* për aq herë sa kemi ndërhyrje të natyrës politike në strukturën e Këshillit të Ministrave, si dhe për të siguruar vazhdimësinë e punës së KKSHC-së.

Së fundmi, thembra e Akilit e këtij mekanizmi bashkëpunimi qëndron tek çështja e pronësisë (ownership) mbi KKSHC-në dhe përgjigjes së pyetjes: "*Kush flet në emër të këshillit? Ministri apo 13 OSHC-të anëtare?*". Kuadri ligjor aktual krijon mundësi varësie të këshillit nga zhvillimet politike në vend dhe cënon autonominë e tij si strukturë ndërsektoriale: Së pari, Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile drejtohet nga një ministër me mandat politik, zëvendësimi i së cilit në maj 2017 me një ministër teknik, znj. Xhuljeta Kërtusha, pezulloi funksionimin e punës së KKSHC-së në praktikë sepse asnjë mbledhje nuk u zhvillua (nga maji deri në shtator 2017). E njëjta gjë ndodhi më pas me shkriren e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në strukturën e Këshillit të Ministrave, çka shkaktoi paqartësi se cila ministri do të pasonte kryesimin e këtij këshilli. Ndërkohë prezenca e OSHC-ve në këshill duhet të shërbejë si element konstruktiv në sigurimin e vijueshmërisë së punës pavarësisht zhvillimeve politike të

momentit, për aq kohë sa qëllimi final është mirëqenia publike. Së dyti, neni 19/5 i rregullores thotë që "[n]ë rast barazim votash, vota e Kryetarit është ajo që mbizotëron për efekt të vendimmarrjes". Ky nen sanksionon dominancën dhe mosbarazinë midis anëtarëve në të gjitha ato raste kur pozicioni i përfaqësuesve të institucioneve publike është diametralisht i kundërt me atë të përfaqësuesve të OSHC-ve.

PROCESI I THEMELIMIT DHE FUNKSIONIMI I KKSHC-SË


Përfshirja e organizatave të shoqërisë civile në proceset politikëbërëse në Shqipëri [nuk është ende në nivelin e dëshiruar dhe ka ende hapësira për përmirësim](#). Vetë organizatat hasin problematika të ndryshme, duke filluar që nga procedurat e regjistrimit pranë institucioneve përgjegjëse e deri tek ligji për rimbursimin e TVSH-së. Vet fakti që nuk ka ende një regjistër të unifikuar për organizatat e shoqërisë civile apo një numër të saktë të organizatave aktualisht aktive në Shqipëri është një aspekt i rëndësishëm për t'u patur parasysh sepse ndikon drejtpërdrejt në procesin e përzgjedhjes së anëtarëve përfaqësues të OSHC-ve në një mekanizëm të tillë si Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile.

Duke u fokusuar së pari tek hapat e ndjekur për themelimin e KKSHC-së, siç shihet në figurën 1, nga miratimi i ligjit 119/2015 e deri në fillimin zyrtar të mandateve të anëtarëve të këshillit kanë kaluar pothuajse tre vjet. Vet [procesi i përzgjedhjes së anëtarëve përfaqësues të OSHC-ve nuk ishte i mirëpërcaktuar](#) në ligjin 119/2015. Dispozitat kalimtare parashikonin një proces relativisht të shpejtë, ku brenda 20 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit duhet të përcaktoheshin rregullat e detajuara të procesit të përzgjedhjes dhe jo më vonë se 45 ditësh duhet të zhvillohen procedurat e përzgjedhjes. Hartuesit e ligjit duket se nuk

kanë marrë parasysh as vështirësitë operacionale në sektorin e OSHC-ve – i cili ka ende nevojë për një rregullim më të

strukturuar - dhe as kapacitetet teknike dhe njerëzore.

Figura 1: Hapat kryesorë të themelimit të KKSHC-së



Burimi: Përpunim i autorit.

Sipas ligjit në fuqi, procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të parë përfaqësues të OSHC-ve duhet të zhvillohet nëpërmjet një procedure publike dhe transparente, e cila është organizuar nga vet OSHC-të, duke ndjekur kriteret dhe procedurat që ata dakordësojnë mes tyre. Ndërkohë, AMSHC luan një rol lehtësuesi në këtë proces, duke dhënë asistencë teknike në organizimin e procedurave dhe publikimin e rezultateve.

votimit elektronik të anëtarëve përfaqësues të OSHC-ve. Ndonëse në parim votimi elektronik do të siguronte një transparencë të lartë dhe precizion në kohë reale për dhënien e rezultateve finale, për shkak të sfidave që rrjedhin nga mungesa e një regjistri identifikues të unifikuar elektronik të organizatave të shoqërisë civile aktive në Shqipëri, rezultati final i të gjithë këtij procesi votimi ka qenë edhe më i vështirë për t'u arrirë.

Procesi i përzgjedhjes nisi me hapjen e periudhës së konsultimit me organizatat e shoqërisë civile në datën 28/12/2015 dhe përfundoi zyrtarisht me shpalljen e rezultateve në 13/06/2018. Periudha e konsultimit synonte informimin e organizatave nga AMSHC rreth ngritjes së kësaj strukture të re bashkëpunimi me institucionet shtetërore dhe përcaktimin e kriterëve të përzgjedhjes së kandidatëve për të qenë anëtarë nga radhët e shoqërisë civile. Në tërësi, i gjithë ky proces u krye nga AMSHC dhe jo nga vet organizatat, sikurse e parashikonte ligji.

Problematikat që hasi procesi i votimit online gjeneruan [një numër të konsiderueshëm votash të pavlefshme](#). Për të shprehur preferencën e tyre online, organizatave ju kërkua të identifikoheshin me disa informacione personale si kodi i regjistrimit (NIPT), emri i drejtorit ekzekutiv, etj. Këto informacione ishin lehtësisht të aksesueshme në internet – vet Kuvendi i Shqipërisë ka të publikuar një listë me këto informacione në [faqen e tij](#) të internetit - dhe u krijua mundësia për abuzime nga vet radhët e OSHC-ve. Gjendur përballë këtyre vështirësive, AMSHC kërkoi asistencë teknike ndërkombëtare në mënyrë që të gjendeshin alternativa të mundshme për mbylljen me sukses të këtij procesit të tejzgjatur.

Duke ju referuar tabelës 1, procesi i përzgjedhjes së anëtarëve nga OSHC-të është përballur me një sërë sfidash të brendshme dhe të jashtme, që kanë rezultuar më pas në shtyrje të përsëritura të afateve të parashikuara dhe zvarritje në ngritjen e këshillit. Sfidat e brendshme lidhen me kapacitetet e AMSHC-së për të ndërmarrë përsipër një proces informimi dhe përzgjedhjeje nëpërmjet instrumenteve të

Për efekt ilustrimi po fokusohemi vetëm tek faza e votimit online, e cila zgjati nga data 31 mars deri më 7 prill 2016. Gjatë këtij harku kohor pati gjithsej 1141 vota online, ndonëse verifikime parapake të

kryera nga AMSHC treguan që nuk ishte efektivisht i shprehur vullneti i po aq organizatave. Intervistat e kryera për qëllimet e këtij punimi treguan se përballë situatës faktike së mbërritjes së një numri të konsidueshëm votash në një hark të shkurtër kohor (gjatë orarit të natës) për të njëjtin kandidat, AMSHC vendosi të aplikonte disa filtra, si kontrolli i votave të ardhura nga i njëjti IP, të dhënat e marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për OSHC-të me status aktiv, etj. Parë në këndvështrim a posteriori, duke pranuar që rreziku i abuzimit me votat lidhet ngushtë me qenien njerëzore dhe ambicien personale – ku asnjë profesion nuk ka imunitet – procesi i verifikimit të votave duhet të ishte paramenduar që në nisje të procesit të përzgjedhjes së anëtarëve dhe duheshin deklaruar publikisht mekanizmat që do të përdreshin në këtë drejtim. Kjo qasje do të frenonte abuzimet e mundshme nga ana e

OJF-ve apo kandidatëve. Gjithashtu, përdorimi i masave parandaluese mund të shoqërohej me ndërgjegjësimin e kandidatëve mbi mundësitë e përjashtimit të tyre nga kandidimi në rast verifikimi të abuzimit.

Nga ana tjetër, disa çështje mund të ishin adresuar disi më lehtësisht nga AMSHC. Për shembull, koha e lënë në dispozicion për kontestimin nga ana e kandidatëve të skualifikuar nuk ka qenë në respekt të parimit bazë të tre ditëve të punës. Në tabelën 1 vërehet se afatet e përcaktuara kanë përkuar në dy raste me ditët e pushimit zyrtar (e shtunë – e dielë). Këto gabime në llogaritje lidhen me kapacitetet njerëzore në dispozicion të sekretariatit teknik të AMSHC-së dhe në raste potenciale mund të çojnë në tejzgjatje të procesit për shkak të ankimimeve të njëpasnjëshme nga të skualifikuarit.

Tabela 1: Kalendar i deklaruar dhe efektiv i përzgjedhjes së kandidatëve nga OSHC-të në KSHC

KALENDARI I PLANIT TË VEPRIMIT							
	Data e njoftimit	Periudha e nominimeve	Ngritja e komisionit ad hoc të vlerësimit	Publikimi i listës së kandidaturave të kualifikuara	Periudha e kontestimit (3 ditë)	Votimi online (8 ditë)	Shpallja e fituesve
Takim konsultiv në prezencë të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, z. Blendi Klosi	04/02/2016	5-12/02/2016	5/02/2016	13/02/2016	14-16/02/2016 (e dielë – e martë)	16 - 24/2/2016	25/02/2016
Njoftim për shtyrjen e procesit të nominimeve të kandidatëve nga OSHC-të	11/02/2016	"Procesi i përzgjedhjes së kandidateve përfaqësues të shoqërisë civile do të vazhdojë të jetë i hapur."					
Njoftim për kriteret e vlerësimit dhe dokumentacionit përkatës të paraqitur nga kandidatët	29/02/2016	Deri më 21/03/2016, ora 17:00					
Njoftim mbi afatet e procesit të përzgjedhjes së anëtarëve nga shoqëria civile	19/03/2016	Deri më 25/03/2016, ora 14:00		28/03/2016	29-31/03/2016 (e martë – e enjte)	31/03/2016 - 7/04/2016	8/04/2016
Njoftim mbi vlerësimin e kandidaturave nga OSHC-të	19/04/2016	"Faza e aplikimeve për kandidatë është mbyllur dhe vazhdon vlerësimi i kandidaturave."					
Njoftim mbi përfundimin e vlerësimit të kandidaturave nga OSHC-të	22/04/2016	Shpallet lista e kandidaturave të kualifikuara dhe të përjashtuarve.			23-25/04/2016, ora 16:00 (e shtunë – e hënë)		
Njoftim mbi hapjen e votimit online	26/04/2016					26/04/2016, ora 13:00 – 4/05/2016, ora 23:59	
Njoftim mbi procesin e verifikimit të votave	20/05/2016	"Jemi në proces verifikimi të votave. Fituesit do të njoftohen me e-mail në adresat përkatëse."					
Njoftim mbi shpalljen e listës emërore me anëtarët e zgjedhur	14/06/2016						13/06/2016


Burimi: Përpunim i autorit.

Shënim: Tabela pasqyron të gjitha afatet e vendosura nga AMSHC për përzgjedhjen e kandidatëve nga shoqëria civile. Në rreshtin e parë pasqyrohen datat e deklaruara në fillim të procesit të përzgjedhjes (në 4/02/2016) dhe në rreshtat pasues paraqiten datat e rishikuara për secilin hap të procesit. E parashikuar për t'u shpallur në 25/02/2016, lista emërore e anëtarëve të zgjedhur nga shoqëria civile u publikua vetëm në datën 13/06/2016.

Një tjetër problematikë për funksionimin e KKSHC-së lidhet me tejzgjatjen e procesit të miratimit të rregullores dhe ndarjen e mandateve të anëtarëve të përzgjedhur nga shoqëria civile. Neni 5/4 i ligjit 119/2015 specifikon se rregullorja duhet të miratohet gjatë mbledhjes së parë të këshillit me shumicë votash të anëtarëve. Siç vërehet në figurën 2, rregullorja ka qenë pjesë e tre mbledhjeve konsektive të KKSHC-së: draft rregullorja është votuar dy herë dhe dakordësia finale midis anëtarëve

është arritur vetëm në takimin e tretë në 26/12/2017, çka ka shtuar më tej vonesat në themelimin e këshillit. Problematikën e mungesës së rregullores e kanë ngritur disa herë anëtarët nga radhët e OSHC-ve edhe në takimet me palët e treta, si me [përfaqësuesit nga Kryeministria apo nga Delegacioni i BE-së](#), ndërkohë që kuadri ligjor aktual nuk ofron asnjë alternativë apo masë paraprake për zgjidhjen e këtij ngërçi.

Figura 2: Pikat kryesore të diskutuara gjatë takimeve të KKSHC-së²



Burimi: Përpunim i autorit.

² Pikat kryesore të takimit të parë të KKSHC-së në 23/06/2016 janë hartuar mbi bazën e përmbledhjes së publikuar të takimit. Procesverbali i këtij takimi nuk është i disponueshëm online.

Ndërkohë në parim mandatet e anëtarëve të përzgjedhur nga OSHC-të janë mandate personale dhe jo të organizatës që ka mbështetur kandidimin e këtij anëtar. Ata janë mbështetur gjatë procesit të përzgjedhjes nga OJF-të dhe e ushtrojnë mandatin pranë KKSHC-së për aq kohë sa nuk krijohen kushte të papajtueshmërisë apo të konfliktit të interesit. Deri më tani janë zëvendësuar dy anëtarë përfaqësues të OSHC-ve në KKSHC, të cilët janë larguar në mënyrë vullnetare. Në njërin rast rezultoi në procesverbal largimi dhe zëvendësimi i anëtarit,³ ndërkohë në rastin tjetër nuk rezultoi ndonjë dokumentim me shkrim në faqen e internetit të këshillit. Zëvendësimi i tyre është bërë me dy kandidatët më të votuar të cilët gjendëshin në pozicionet pasuese të listës finale të publikuar në 13/06/2016.

Përballë kërkesës specifike të ngritur nga anëtarë përfaqësues të OSHC-ve në mbledhjen të KKSHC-së mbi nevojën për procedim për ndarjen e mandateve, përgjigjja e marrë është që "[procesi është shumë i qartë në nenin në fundit të ligjit](#)". Ndërkohë që dispozitat kalimtare në fjalë shprehet se: "[p]as shpalljes së kandidatëve fitues, AMSHC-ja organizon një short për të përcaktuar kohëzgjatjen e mandatit të secilit anëtarët të KKSHC-së", pra sekretariati teknik duhet të kishte organizuar shortin e ndarjes së mandateve në javët pasuese pas datës së shpalljes së fituesve. Analiza e procesverbaleve të mbledhjeve të KKSHC-së dhe komunikimi zyrtar me sekretariatit teknik tregon që mandati i anëtarëve filloi më 26/12/2017.

Bazuar në nenin 22/2 të rregullores, AMSHC, në rolin e sekretariatit teknik të këshillit, duhet të zhvillojë procedurat e përzgjedhjes së katër anëtarëve të rinj (të cilëve u skadon mandati një vjeçar) gjatë

periudhës shtator-tetor 2018, të cilët do të marrin pjesë në mbledhjen e parë vjetore të KKSHC-së në 2019. Organizimi i zgjedhjeve çdo vit kërkon kapacitete dhe angazhim të posaçëm nga ana e AMSHC-së.

Në respekt të parimit të transparencës dhe gjithëpërfshirjes në aktivitetet e këshillit, rregullorja përcakton në nenet 7 dhe 8 që AMSHC të ngrëjë një platformë online për shkëmbim informacioni dhe konsultim të KKSHC-së me shoqërinë civile. Aktualisht është funksionale një faqe interneti e KKSHC-së - e aksesueshme nëpërmjet faqes së AMSHC-së - ku janë të disponueshëm për konsultim publik procesverbalet e mbledhjeve të këshillit dhe të takimeve të grupeve të punës së anëtarëve të shoqërisë civile. Faqja e internetit nuk mund të konsiderohet ende një platformë ndërvepruese ku mund të paraqiten problematika nga OJF-të e ndryshme dhe nevojitet investim në ngritjen e një serveri për ruajtjen e të dhënave të publikuara. Ruajtja e materialeve në google drive nuk ndihmon në ngritjen e imazhit të vet KKSHC-së.

Një tjetër çështje e rëndësishme mbetet raporti midis anëtarëve përfaqësues të OSHC-ve dhe bashkëpunimi i tyre me kolegët përfaqësues të institucioneve publike. Aktualisht KKSHC nuk ka përmbushur asnjë nga detyrat kryesore të përcaktuara nga ligji, në terma dhëniesh mendimi, këshillash apo rekomandimesh. Ai ka miratuar vetëm një [Deklaratë mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm](#) në kuadër të Agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara, gjatë takimit të qershorit 2018. Nga njëra anë, kjo lidhet me fragmentarizimin që ekziston midis anëtarëve përfaqësues të OSHC-ve, çka u vu re edhe në [mosdakordësinë](#)⁴ dhe tejzgjatjen

⁴ Anëtarët përfaqësues të OSHC-ve patën vështirësi në gjetjen e një dakordësie mbi vendosjen e kritereve që duhet të përmbusheshin nga kandidatët për zëvendëskryetar të KKSHC-së. Diskutimet nisën

³ Znj. Migena Shulla dorëhiqet dhe vendin e saj e merr znj. Aferdita Seiti.

e procesit të përzgjedhjes së zëvendëskryetarit të KSHC-së nga radha e organizatave, i cili u [përmbyll vetëm në dhjetor 2017](#). Nga ana tjetër, përfaqësuesit nga institucionet publike janë të një niveli të lartë drejtues dhe për shkak të angazhimeve të shumta politike që ata kanë në portofolin e tyre të punës, shpesh këta përfaqësues zëvendësohen nëpër mbledhje me zyrtarë të një niveli më të ulët, të cilët nuk kanë fuqi vendimmarrëse.

Kuadri ligjor aktual rregullon vetëm prezencën e anëtarëve përfaqësues të OSHC-ve në mbledhjet e këshillit, duke mos u prononcuar rreth anëtarëve nga rradhët e institucioneve publike. Në rast mungese në të paktën tre mbledhje të KSHC-së të organizuara gjatë një viti, anëtarë i OSHC-ve humbet mandatin. Ndërkohë përsa i përket takimeve të grupeve të punës së anëtarëve të OSHC-ve, prezenca nuk është e rregulluar apo e detyrueshme. Nga analiza e bërë e procesverbaleve të *10 takimeve* të këtyre grupeve të punës në periudhën 7/9/2017-12/4/2018 është vënë re se 5 anëtarë nga 13 kanë një pjesëmarrje të ulët në këto takime (≤ 4 takime). Prania apo mosprania e tyre lidhet ngushtë si me njoftimin në kohë nga sekretariati teknik për organizimin e takimit (duke patur parasysh që jo të gjithë anëtarët jetojnë në Tiranë), agjendat personale të organizatave jofitimprurëse, por edhe me motivimin dhe pronësinë (ownership) mbi këtë këshill nga vetë anëtarët.

Duke filluar nga fillimi i vitit 2018, KSHC pritet të respektojë detyrimet ligjore mbi mbajtjen e së paku tre takimeve vjetore, hartimin e raportit vjetor mbi punën e kryer, si dhe rritjen e transparencës gjatë procesit të përzgjedhjes së anëtarëve të rinj në vjeshtë. Nga ana e tyre, anëtarët e OSHC-ve pritet të jenë më proaktiv në angazhimin e tyre në KSHC, duke patur

parasysh që nevojitet kërkesa e vetëm 9 anëtarëve për të thirrur një mbledhje të këshillit për çështje me interes specifik për këtë sektor.

EKSPERIENCA NGA RAJONI

Pas rënies së regjimit komunist, shumë vende të Evropës Qendrore dhe Juglindore proceduan me ngritjen e këshillave kombëtar për bashkëpunim midis qeverisë dhe shoqërisë civile. Në këtë linjë proceduan edhe Kroacia, e cila ngriti një këshill të tillë në 2009, si dhe Mali i Zi në vitin 2010. Modeli kroat u konsideruar si një mekanizëm i frytshëm dhe u përshtat më pas si model për themelimin e KSHC-së në Shqipëri.

I ngritur nën emërtimin e [Këshillit për Zhvillimin e Shoqërisë Civile](#), **modeli kroat** përbëhet nga 37 anëtarë, prej të cilëve 17 përfaqësojnë administratën shtetërore, 14 anëtarë përfaqësojnë organizatat joqeveritare jofitimprurëse, 3 përfaqësues vijnë nga fondacionet, sindikatat dhe shoqatat e punëdhënësve, si dhe 3 përfaqësues nga shoqatat kombëtare të qeverisjes vendore dhe lokale. Këshilli drejtohet nga presidenti, i cili zgjidhet nga radhët e anëtarëve përfaqësues të shoqërisë civile, ndërsa zëvendëspresidenti midis anëtarëve të institucioneve shtetërore. Mandati i anëtarëve, presidentit dhe zëvendëspresidentit zgjat tre vjet me të drejtë rizgjedhjeje. Roli i tij është t'i [ofrojë këshillim qeverisë mbi politikën dhe strategjitë e zhvillimit të OSHC-ve, si dhe të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme zhvillimet në këtë drejtim](#). Përsa i përket [problematikave të hasura nga Këshilli kroat për Zhvillimin e Shoqërisë Civile](#), do të përmendim: (i) vështirësi në vendimmarrje për shkak të përzgjedhjes së anëtarëve përfaqësues nga rangje jo të larta të administratës publike; (ii) anëtarët përfaqësues të OSHC-ve nuk kanë një lidhje funksionale me organizatat në 'bazë' të cilët ata përfaqësojnë; dhe (iii) mungesa e

gjatë takimit të datës mars 2017 dhe procesi i përzgjedhjes së zëvendëskryetarit u mbyll pas nëntë muajsh.

efikasitetit të këshillit për shkak të numrit të lartë të anëtarëve.

Ndërsa *Këshilli për Bashkëpunim me OJF-të* në **Mal të Zi** ka një përbërje të barabartë anëtarësh, gjithsej 24, ku 12 anëtarë përfaqësojnë qeverinë dhe 12 përzgjidhen nga radhët e organizatave të shoqërisë civile nëpërmjet një thirrje publike. [Kryetari i Këshillit është një prej përfaqësuesve të qeverisë, ndërsa zëvendëskryetari zgjidhet në bazë të propozimeve të ardhura nga këshilli](#). Të gjithë anëtarët e këshillit emërohen nga Këshilli i Ministrave me një mandat 3 vjeçar. Fokusi kryesor i këtij këshilli është monitorimi i zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit për bashkëpunimin e qeverisë me OJF-të, përfshirja e shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e politikave publike, si dhe dhënia e opinioneve për zhvillimin e këtij sektori.

Në të dy rastet e përmendur më sipër, sekretariati teknik i këshillit është përzgjedhur një institucion publik i dedikuar bashkëpunimit me OJF-të, simotra e AMSHC-së në Shqipëri. Në rastin e modelit kroat anëtarët nuk marrin asnjë kompensim për kontributin e tyre, ndërsa [në rastin malazez anëtarët marrin kompensimin financiar përkatës](#).

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile është një mekanizëm ende i ri, ndonëse themelimi i tij daton që në 2016. Ky institucion bashkëpunimi ndërsektorial ka nevojë për një mbështetje më të madhe teknike dhe në drejtim të transparencës, informimit dhe përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile. Në këtë drejtim, disa rekomandime për përforsimin e KKSHC-së janë:

1. Nevojitet së pari një rishikim i kuadrit ligjor dhe forcim i kapaciteteve institucionale për të mundësuar vijueshmërinë e punës dhe autonominë e këshillit nga institucionet e tjera të

administratës publike. Përpos problematikave të përmendura në seksionin përkatës, nevojitet gjithashtu një harmonizim midis nenit 8 dhe 20 të rregullores mbi publikimin dhe shpërndarjen e vendimeve të KKSHC-së. Vendimet duhet të jenë të aksesueshme online dhe nuk duhet të shtohen procedurat burokratike për çdo subjekt të interesuar nëpërmjet dorëzimit të kërkesave me shkrim pranë sekretariatit teknik për të marrë një kopje të një vendimi të këshillit.

2. Nevojitet një investim serioz në ndërtimin e platformës interaktive të KKSHC-së dhe mbushjen e saj me informacion të plotë, si p.sh.: (i) publikimi i kriterëve të përzgjedhjes së anëtarëve; (ii) lista e anëtarëve të përzgjedhur dhe anëtarëve potencial që gjenden në listën e pritjes – për raste të mundshme zëvendësimi; (iii) publikim të njoftimeve dhe agjendave të mbledhjeve të këshillit dhe të grupeve të punës; (iv) ndërtimi i një serveri të posaçëm për ruajtjen e të dhënave; (v) monitorim të ndërveprimit që kanë palët e treta me faqen e internetit të këshillit; etj. Këto informacione publike do të rrisnin transparencën e punës së këshillit.
3. AMSHC duhet të investojë në unifikimin e procedurës dhe formatit të hartimit të procesverbaleve si për mbledhjet e këshillit dhe për takimet e grupeve të punës. Ndryshe nga procesverbalet e mbledhjeve të KKSHC-së, procesverbalet e takimeve të grupeve të punës aktualisht janë relativisht të shkurtër dhe proporcionalisht dominon mbulimi i pozicioneve të përfaqësuesve të AMSHC-së karshi anëtarëve të OSHC-ve në një grup pune specifik. Rekomandohet që këto procesverbale të hartohen ose sipas deklaratave të dhëna nga secili përfaqësues ose nëpërmjet

përmbledhjeve të pozicioneve sipas nën-temave në diskutim. Gjithashtu, referenca e folësve duhet të unifikohet në të gjithë procesverbalet duke përdorur mbiemrin, (p.sh. [Znj. Manastirliu dhe jo Znj. Ogerta](#)), si një praktikë e mirë e zbatuar nga institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare.

4. Duke qenë së në formatin aktual AMSHC duhet të organizojë zgjedhje çdo vit për anëtarë të rinj nga radhët e shoqërisë civile në KKSHC, nevojitet një vlerësim i thelluar i mundësive dhe sfidave të mbajtjes së këtyre zgjedhjeve nëpërmjet procesit të votimit online, për të mos cënuar besueshmërinë tek këshilli. Gjithashtu, aktualisht nevojitet një fushatë informuese mbi zhvillimin e raundit të dytë të votimeve për përzgjedhjen e kandidatëve të rinj të KKSHC-së deri në muajin shtator 2018.
5. Sekretariati teknik i këshillit duhet të organizojë takime informuese dhe diskutime me organizatat në rrethe, për të identifikuar problematikat e tyre, të cilat më pas duhet të reflektohen në mbledhjet e këshillit. Këto takime duhet të pasohen me outpute konkrete dhe jo të mbesin në kuadrin e mbledhjes së thjeshtë konsultuese.
6. KKSHC duhet të marrë masat e nevojshme për një stimulim financiar ndaj anëtarëve përfaqësues të shoqërisë civile, çka do të mund të sigurojë angazhimin dhe motivimin e tyre. Në këtë mënyrë do të sigurohej gjithashtu edhe barazia me anëtarët përfaqësues të administratës publike, të cilët marrin pjesë në kuadër të përkrahimit të tyre të punës në institucionet përkatëse.
7. KKSHC duhet të publikojë planin strategjik të punës dhe kalendarin e veprimtarive vjetore.
8. Në pamundësi për të hartuar një raport vjetor për periudhën 2016-2017, KKSHC duhet të publikojë një përmbledhje të detajuar të zhvillimeve kryesore të atyre dy viteve për audiencën e gjerë.
9. Nevojitet një rishikim i praktikës në rast mospjesëmarrjeje të përsëritur të anëtarëve të OSHC-ve në takimet e grupeve të punës, si dhe forcim të komunikimit dhe ndërveprimit të këtyre anëtarëve me përfaqësuesit e institucioneve publike, për të rritur kështu efektivitetin dhe motivimin në vazhdimësi.